



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 138

24 tetor

2012

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.668, datë 26.9.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për organizimin dhe realizimin e ekspozitës “Thesare të kulturës shqiptare”, nga data 20 nëntor 2012 deri në datën 6 janar 2013	7785
Vendim i KM nr. 671, datë 3.10.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për organizimin e ceremonive zyrtare për ekspozimin e “Mesharit” të Gjon Buzukut, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare, dhe për ekspozimin e armëve të Skënderbeut, në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar	7785
Vendim i KM nr. 672, datë 3.10.2012	Për autorizimin e “ZODIAC” sh.p.k. për importin e mbetjeve metalike të aluminit, bakrit, bronzit, tunxhit dhe zinkut për qëllime riciklimi	7786
Vendim i KM nr.708, datë 24.10.2012	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të projektit “Dekori i 100 – Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”	7793
Vendim i KM nr. 709, datë 24.10.2012	Për procedurat e financimit të projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore	7794

VENDIM
Nr.668, datë 26.9.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR ORGANIZIMIN DHE
REALIZIMIN E EKSPOZITËS “THESARE TË KULTURËS SHQIPTARE”, NGA DATA 20
NËNTOR 2012 DERI NË DATËN 6 JANAR 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, t’i shtohet fondi prej 20 140 400 (njëzet milionë e njëqind e dyzet mijë e katërqind) lekësh, për organizimin dhe realizimin e ekspozitës “Thesare të kulturës shqiptare”, nga data 20 nëntor 2012 deri në datën 6 janar 2013.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 671, datë 3.10.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR ORGANIZIMIN E
CEREMONIVE ZYRTARE PËR EKSPOZIMIN E “MESHARIT” TË GJON BUZUKUT, NË
MJEDISËT E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE, DHE PËR EKSPOZIMIN E ARMËVE TË
SKËNDERBEUT, NË MJEDISËT E MUZEUT HISTORIK KOMBËTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në zërin “Projekte”, artikulli 604, t’i shtohet fondi prej 1 003 456 (një milion e tri mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh, për organizimin e ceremonive zyrtare për ekspozimin e “Mesharit” të Gjon Buzukut, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare, dhe fondi prej 1 280 000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekësh, për ekspozimin e armëve të Skënderbeut në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar, sipas preventivave bashkëlidhur këtij vendimi.



2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 672, datë 3.10.2012

PËR AUTORIZIMIN E “ZODIAC” SHPK PËR IMPORTIN E MBETJEVE METALIKE TË ALUMINIT, BAKRIT, BRONZIT, TUNXHIT DHE ZINKUT PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e “ZODIAC” sh.p.k., për importin e mbetjeve metalike të aluminit, bakrit, bronzit, tunxhit dhe zinkut, për qëllime riciklimi, me Kodin Doganor:

- GA 7602 00 mbetje dhe kthime të aluminit;
- GA 7404 00 mbetje dhe kthime të bakrit (bronzit, tunxhit);
- GA 7902 00 mbetje dhe kthime të zinkut;

dhe kodin B1-B1010 të Konventës së Bazelit, aneksi 1 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

2. Sasia e mbetjeve metalike të aluminit, bakrit, bronzit, tunxhit dhe zinkut, që importohet, sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 7 000 (shtatë mijë) tonë.

3. Mbetjet do të importohen nga Mali i Zi, Kosova, Maqedonia, vendet e BE-së dhe Lindja e Mesme. Transporti do të bëhet në rrugë tokësore dhe detare, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve me qëllim përdorimi, përpunimi dhe riciklimi”. Ambalazhimi i tyre do të bëhet në paleta, i presuar ose në thasë plastikë, konform aneksit III të vendimit nr. 550, datë 22.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, “ZODIAC” sh.p.k., dorëzon të plotësuar, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në aneksin IV të vendimit nr. 550/2012 të Këshillit të Ministrave, ndërsa monitorimi i tyre do të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

4. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve metalike të aluminit, bakrit, bronzit, tunxhit dhe zinkut nga “ZODIAC” sh.p.k., do të jetë për një afat kohor 1-vjeçar (njëvjeçar), nga data e miratimit në Këshillin e Ministrave.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve metalike të aluminit, bakrit, bronzit, tunxhit dhe zinkut nga “ZODIAC” sh.p.k., pas miratimit të këtij vendimi, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato transitore për autorizimet përkatëse, që lejojnë kalimin e kësaj sasive të mbetjeve të aluminit, në përmbushje të kërkesave të konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Aneks 3

Dokumenti i njoftimit per transferta/levizje nderkufitare te mbetjeve

1. Rregjistrimi i Eksportuesit – njoftuesit Numri: 70462177 Emri: G+ Adresa: <i>Obliq-Roskovo-Prishtine-Kosovo</i> Personi i kontaktit: <i>Genc Rushiti</i> Tel: 0037744192262 Fax: 0038138544007 E-mail: g-+@live.com Numri: 70468084 Emri: <i>REC-KOS shpk</i> Adresa: <i>Fushe Kosove-Kosovo</i> Personi i kontaktit: <i>Valdet Shaqiri</i> Tel: 0038643721294 Fax: 0038643721295 E-mail: reckos@live.com Numri: 02049520 Emri: <i>UNIPROM</i> Adresa: <i>Novaka Ramova-Nikshiq-Cerna Gore</i> Personi i kontaktit: <i>Pjoviq Veselin</i> Tel: 0038240213503 Fax: 0038240212709 E-mail: uniprom-office@t-com.me Partita IVA: 00628160558 Emri: <i>Trentavizi spa</i> Adresa: <i>Via dei Fornaciari, 11, 05010 Orvieto(Tr) Italia</i> Personi i kontaktit: <i>Trentavizi</i> Tel: 0039763316106 Fax: 00397633161308 Cod.Fis: 90004090552 Emri: <i>EUROGULF, Minerals and metals ltd</i> Adresa: <i>Abboud Trading Center, Wasfi Al-Tal St.</i> <i>Office 103 Amman 11953 P.O. Box 2659, Jordan</i> Personi i kontaktit: <i>Abed Abu-Hadba</i> Tel: (+ 962 6) 553-2932 Fax: 0038138544007 (+ 962 6) 552-2941 Emri: <i>YES-AN METAL Ltd</i> Adresa: <i>Kakheti Highway 63 Tbilisi, Georgia</i> Personi i kontaktit: <i>Muhsin Kurt</i> Tel: +995 32 143322 Fax: +995 32 143322 E-mail: yesanmetal@yahoo.com	3. Njoftimi Nr: Njoftim per: A.(i) Transferte te vetme: ☐ (ii) transferta te shumfishta: ☒ B. (i) Asgjesim (1): ☐ (ii) Rikuperim : ☒ C. Impianti i rikuperimit i miratuar paraprakisht: (2,3) Po ☒ Jo ☐ 4. Numri total i transfertave te synuara: 45
---	--

2. Importuesi – marresi ne dorezim Numri i regjistrimit: <i>J62014008P</i> Emri: <i>ZODIAC</i> Adresa: <i>Xhafzotaj, Durres</i> Personi i kontaktit: <i>Reshat Mansaku</i> Tel: <i>048202851</i> Fax: <i>048202854</i> E-mail: <i>zodiac@abcom.al</i>		5. Sasia totale e synuar (4): Ton (Mg): <i>7000 ton</i> m ³ :	
8. Transportuesi e pritshem Numri i regjistrimit: <i>J62014008P</i> Emri: <i>ZODIAC</i> Adresa: <i>Xhafzotaj, Durres</i> Personi i kontaktit: <i>Reshat Mansaku</i> Tel: <i>048202851</i> Fax: <i>048202854</i> E-mail: <i>zodiac@abcom.al</i> Mjeti i transportit (5): <i>R&D</i>		6. Periudha e kohes se synuar per transfert/en/at (4): Nisja e pare: <i>Dhjetor 2011</i> Nisja e fundit: <i>Dhjetor 2012</i> 7. Lloj/i/et e paketimit/amballazhimit (5): <i>5</i> Kerkesa te vecanta per kujdesje gjate transferimit: (6): Po: ☐ Jo: ☒	
9. Gjeneruesi/t e mbetjeve - prodhuesi/t (1;7;8) Numri i regjistrimit: Emri: Adresa: Personi i kontaktit: Tel: Fax: E-mail: Sheshi dhe procesi i gjenerimit (6):		11. Operacionet e Rikuperimit (2) D-code / R-code (5): <i>R4</i> Teknologjia qe perdoret (6): <i>Riciklim</i> Aresyet per eksport (1;6): <i>Riciklim</i>	
10. Impjant asgjesisimi(2): ☐ apo Impjant rikuperimi (2): ☒ Numri i regjistrimit: <i>J62014008P</i> Emri: <i>ZODIAC</i> Adresa: <i>Xhafzotaj, Durres</i> Personi i kontaktit: <i>Reshat Mansaku</i> Tel: <i>048202851</i> Fax: <i>048202854</i> E-mail: <i>zodiac@abcom.al</i> Sheshi aktual i asgjesisimit/ rikuperimit:		12. Emri dhe perberja e mbetjes (6): <i>Mbetje (skrap) alumini, bakri dhe lidhjet e tij (bronz, tunxh), zink</i> 13. Karakteristika fizike (5): <i>2</i> 14. Identifikimi i mbetjes (plotesoni kodet e duhura) (i) Aneksi VIII (ose IX nese ka kuptim) i Bazelit <i>B1010</i> (ii) Kodi i OECD (nese i ndryshem nga (i)): <i>170402, 170401, 170404</i> (iii) Lista e mbetjeve e Komisionit Evropian: (iv) Kodi nacional ne vendin e eksportit: (v) Kodi nacional ne vendin e importit: <i>170402, 170401, 170404</i> (vi) Te tjera (specifikoni): (vii) Kodi Y: (viii) Kodi H (5): (ix) Klasa e BE-se (5): (x) Numri i BE-se: (xi) Emri i transferes se BE-se: (xii) Kod/i/et e doganave (HS): <i>GA140ex760220, GA120ex740400, GA160740700</i>	
15. (a) Vendet/shtetet e interesuara, (b) Nr. i kodit te autoritetit kompetent aty ku eshte e aplikueshme, (c) Pikat e vecanta te daljes apo te hyrjes (kufijte apo portet ku kalon)			
Shteti eksportues – nga ku behet dalje	Shtet/i/et e tranzitit (te hyrjes dhe daljes)		Shteti importues – destinacioni
(a) <i>KOSOVE</i>			<i>SHQIPERI</i>
(b) <i>ITALI</i>			<i>SHQIPERI</i>
(c) <i>MAL I ZI</i>			<i>SHQIPERI</i>
16. Zyrat e doganave te hyrjes dhe /ose daljes dhe/ose teeksportit (Komuniteti Europian):			
Hyryja: <i>Qafe Thane, Muriqan, Morine, Durres</i>	Dalja: <i>Durres, Tirane</i>		Eksporti: <i>Kosove, Itali, Mal i Zi</i>



17. Deklarata e Eksportuesit – njoftuesit – gjeneruesit – prodhuesit (1): Vertetohet se në vijën e informacionit është i plotë dhe korrekt. Gjithashtu vertetohet se janë shënuar detyrimet kontraktuale të shkruara ligjore dhe të detyrueshme dhe çdo sikuracion apo garanci financiare që është ose do të jetë në fuqi në lidhje me levizjen nderkufitare.	
Emri i eksportuesit – njoftuesit: G+ REC-KOS shpk UNIPROM Trentavizi spa EUROGULF, Minerals and metals ltd YES-AN METAL Ltd	Data: _____ Firma: _____
18. Numri i anekseve të bashkangjitura:	
Emri i gjeneruesit – prodhuesit: _____ Data: _____ Firma: _____	
PER PERDORIM NGA AUTORITETET KOMPETENTE	
19. Njohja nga autoriteti kompetent respektiv i vendeve të importit – të destinacionit/ tranzitit (1)/ eksportit – të daljes (9): Emri i vendit: Njoftimi i marrë me datë: Njohja e njoftimit dërguar me datë: Emri i autoritetit kompetent: Vula dhe/apo firma:	20. Miratimi me shkrim (1;8) për levizjen nga autoriteti kompetent i (emri i vendit): Miratimi dhënë me datë: Miratimi i vlefshëm nga data: Deri me datë: Kushte speciale: Jo: ☐ Nëse Po, shih bllokun 21 ☐ (6): Emri i autoritetit kompetent: Vula dhe/apo firma:
21. Kushte specifike për lejimin e levizjes apo arsytet për kundërshtimin e saj	
(1) Kerkohet nga Konventa e Bazelit (2) Në rastin e një operacioni R12/R13 apo D13-D15, bashkangjiten edhe informacionin korrespondues mbi çdo impjant pausës R12/R13 apo D13-D15 dhe për impjant/in/et pasuese R1-R11 apo D1-D12nëse kerkohen/janë të nevojshme. (3) Të plotësohen për levizjet brenda zonës së vendeve të OECD dhe vetëm nëse aplikohet pika B(ii) (4) Bashkangjiten listën e detajuar në rastin kur bëhet fjalë për transferatë të shumëfishta (5) Shih listën e shkurtimeve dhe kodeve në faqen tjetër (6) Bashkangjiten detaje nëse është e nevojshme (7) Bashkangjiten listën nëse ka më shumë se një (8) Në rastin kur kerkohet nga legjislacioni kombëtar (9) Nëse është e aplikueshme në Vendimin e OECD	

Aneks 4

Dokumenti i levizjes per levizjet/transfertat nderkufitare te mbetjeve

1. Korrespondon me njoftimin nr.	2. Numri i serise/total i transfertave 45
3. Regjistrimi i eksportuesit – njoftuesit Numri: 70462177 Emri: G+ Adresa: <i>Obliq-Roskovo-Prishtine-Kosovo</i> Personi i kontaktit: <i>Genç Rushiti</i> Tel: 0037744192262 Fax: 0038138544007 E-mail: g-+@live.com Numri: 70468084 Emri: <i>REC-KOS shpk</i> Adresa: <i>Fushe Kosove–Kosovo</i> Personi i kontaktit: <i>Valdet Shagiri</i> Tel: 0038643721294 Fax: 0038643721295 E-mail: reckos@live.com Numri: 02049520 Emri: <i>UNIPROM</i> Adresa: <i>Novaka Ramova-Nikshiq-Cerna Gore</i> Personi i kontaktit: <i>Pjoviq Veselin</i> Tel: 0038240213503 Fax: 0038240212709 E-mail: uniprom-office@t-com.me Partita IVA: 00628160558 Emri: <i>Trentavizi spa</i> Adresa: <i>Via dei Fornaciari,11,05010 Orvieto(Tr) Italia</i> Personi i kontaktit: <i>Trentavizi</i> Tel: 0039763316106 Fax: 00397633161308 Cod.Fis: 90004090552 Emri: <i>EUROGULF, Minerals and metals ltd</i> Adresa: <i>Abboud Trading Center, Wasfi Al-Tal St.</i> Office 103 Amman 11953 P.O. Box 2659, Jordan Personi i kontaktit: <i>Abed Abu-Hadba</i> Tel: (+ 962 6) 553-2932 Fax: 0038138544007 (+ 962 6) 552-2941 Emri: <i>YES-AN METAL Ltd</i> Adresa: <i>Kakheti Highway 63 Tbilisi, Georgia</i> Personi i kontaktit: <i>Muhsin Kurt</i> Tel: +995 32 143322 Fax: +995 32 143322 E-mail: yesanmetak@yahoo.com	4. Importuesi – marresi ne dorezim Numri i regjistrimit: <i>J62014008P</i> Emri: <i>ZODIAC</i> Adresa: <i>Xhafzotaj, Durrës</i> Personi i kontaktit: <i>Reshat Mansaku</i> Tel: 048202851 Fax: 048202854 E-mail: zodiac@abcom.al



5. Sasia aktuale: Ton : 7000 m ³ (Mg):		6. Data aktuale e transferes: Dhjetor 2011 Nisja e fundit: Dhjetor 2012	
7. Amballazhi/paketimi Tip/i/et (1): 5 Numri i pakove: Kërkesa specifike per perkujdesje gjate transportit: (2) Po: ☐ Jo: ☐			
8.(a) Ngarkesa e 1re (3): Numri i regjistrimit: J62014008P Emri: ZODIAC Adresa: Xhafzotaj, Durres Personi i kontaktit: Reshat Mansaku Tel: 048202851 Fax: 048202854 E-mail: zodiac@abcom.al		8.(b) Ngarkesa e 2te: Nr. i regjistrimit: Emri: Adresa: Personi i Kontaktit: Tel: Fax: E-mail:	
8.(c) Ngarkesa e fundit: Nr. i regjistrimit: Emri: Adresa: Personi i Kontaktit: Tel: Fax: E-mail:			
----- Per tu plotesuar nga perfaqesuesi i ngarkeses ----- Mbi 3 ngarkesa (2) ☐			
Mjetet e transportit (1): R&D Data e transferes: Firma:		Mjetet e transportit (1): Data e transferes: Firma:	
9. Gjenerues/i/t – prodhues/i/it e mbetjes (4;5;6) Nr. i regjistrimit: Emri: Adresa: Personi i Kontaktit: Tel: Fax: E-mail: Sheshi i gjenerimit (2)		12. Emri dhe perberja e mbetjes (2): Mbetje (skrap) alumini, bakri dhe lidhjet e tij (bronz, tunxh), zink	
10. Impjant asgjesimi: ☐ apo impjant rikuperimi: ☒ Numri i regjistrimit: J62014008P Emri: ZODIAC Adresa: Xhafzotaj, Durres Personi i kontaktit: Reshat Mansaku Tel: 048202851 Fax: 048202854 E-mail: zodiac@abcom.al Sheshi aktual i asgjesimit/rikuperimit (2)		13. Karakteristika fizike (1): 14. Identifikimi i mbetjes (ploteso kodet e duhura) (i) Aneksi VIII (ose IX nese ka kuptim) i Bazelit B1010 (ii) Kodi i OECD (nese i ndryshem nga (i)): 170402,170401, 170404 (iii) Lista e mbetjeve e Komisionit Evropian: (iv) Kodi nacional ne vendin e eksportit: (v) Kodi nacional ne vendin e importit: 170402,170401, 170404 (vi) Te tjera (specifikoni): (vii) Kodi Y: (viii) Kodi H (5): (ix) Klasa e BE-se (5): (x) Numri i BE-se: (xi) Emri i transferes se BE-se: (xii) Kod/i/et e doganave (HS): GA140ex760220, GA120ex740400, GA160740700	
11. Operacion/i/et e asgjesimit/rikuperimit D-code / R-code (1) R4			
15. Deklarata e Eksportuesit – njoftuesit – gjeneruesit – prodhuesit (4): Vertetohet se ne dijenine time informacioni eshte i plote dhe korrekt. Gjithashtu vertetohet se jane shenuar detyrimet kontraktuale te shkruara ligjore dhe te detyrueshme dhe cdo sikuracion apo garanci financiare qe eshte ose do te jete ne fuqi ne lidhje me levizjen nderkufitare. Emri: G+ REC-KOS shpk Data: Firma: UNIPROM Trentavizi spa EUROGULF, Minerals and metals ltd			

16. Per tu perdorur nga personi i angazhuar ne levizjen nderkufitare nqse kerkohet informacion suplementar	
17. Ngarkesa u mor n e dorezim nga importuesi/marresi (ne rast se importuesi nuk eshte perdoruesi/impjanti):	Data: Emri: Firma:
PER TU PLOTESUAR NGA IMPJANTI I ASGJESIMIT/RIKUPERIMIT	
18. Ngarkesa u mor ne dorezim nga impjanti i asgjesimit apo impjanti i rikuperimit Data e marrjes ne dorezim: ☐ Pranuar: ☐ Refuzuar ☐ Sasia e marre: Ton m ³ : *kontaktoni menjehere autoritetet kompetente (Mg): Data e perafert e asgjesimit/rikuperimit: Operacioni i asgjesimit/rikuperimit (1): Emri: Data: Firma:	19. Vertetoj se asgjesimi/rikuprimi i mbetjeve te pershkruara me lart eshte perfunduar. Emri: Data: Firma dhe vula:

- (1) Shih listen e shkurtimeve dhe kodeve ne faqen tjeter
(2) Bashkangjitni detaje nese eshte e nevojshme
(3) Nqse jane me shume se 3 ngarkesa, bashkangjitni informacionin qe kerkohet ne blloqet 8 (a,b,c).
(4) Kerkohet nga Konventa e Bazelit
(5) Bashkangjitni listen nqse ka me shume se nje
(6) Nqse kerkohet nga legjislacioni vendas

VENDIM
Nr.708, datë 24.10.2012

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR MBULIMIN E
SHPENZIMEVE TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT “DEKORI I 100 – VJETORIT TË
PAVARËSISË SË SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në zërin “projekte”, artikulli 604, t’i shtohet fondi prej 48 456 224 (dyzet e tetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e katër) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të projektit “Dekori i 100-Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 709, datë 24.10.2012

PËR PROCEDURAT E FINANCIMIT TË PROJEKTEVE DHE VEPRIMTARIVE
ARTISTIKE E KULTURORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 26 të ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave të përgjithshme dhe të procedurës për shpalljen e konkurrimit për:

- a) projektide për veprimtari të ndryshme artistike dhe kulturore;
- b) realizimin e veprimtarive kulturore e artistike nga subjekte private, si dhe nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën (festa kombëtare, nderim figurash, përvjetore të mëdha dhe rast pas rasti).

2. Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën urdhëron me shkrim shpalljen e realizimit të konkurrimit për realizimin e veprimtarive artistike-kulturore, duke përcaktuar, për çdo rast, objektin e konkurrimit për realizimin e veprimtarisë artistike e kulturore.

3. Shpallja e konkurrimit botohet në gazeta me tirazh kombëtar e në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën dhe në gazeta ndërkombëtare, sipas rastit.

4. Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën përzgjedh dhe emëron anëtarët e komisionit të vlerësimit.

5. Komisioni i vlerësimit përzgjedh fituesin me vendim unanim ose me shumicë votash.

II. PROCEDURA E FINANCIMIT NË RASTET E KONKURRIMIT TË PROJEKTIDESË

1. Artistët pjesëmarrës paraqesin projektidenë lidhur me veprimtarinë artistike e kulturore, së bashku me një CV të tyre profesionale.

2. Komisioni i vlerësimit përzgjedh tri projektidetë më të mira nga vendi i parë te vendi i tretë me sistem pikësh.

3. Komisioni i vlerësimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së vendimit, i paraqet ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën projektidenë më të mirë.

III. PROCEDURA E FINANCIMIT TË REALIZIMIT TË PROJEKTEVE ARTISTIKE E KULTURORE NGA SUBJEKTET PRIVATE

1. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën shpall objektin e konkurrimit për veprimtarinë artistike dhe kulturore që synon të zhvillojë, i cili përmban:

- a) përshkrimin e veprimtarisë kulturore;
- b) fondin limit të vënë në dispozicion për realizimin e veprimtarisë artistike e kulturore;
- c) afatin e fundit të paraqitjes së ofertave;
- ç) specifikimet teknike për blerjen e mallrave në shërbim të veprimtarisë artistike e kulturore;
- d) planin kohor të realizimit të veprimtarisë artistike e kulturore;
- dh) kriteret e vlerësimit të ofertës.

Nëse projekti do të realizohet me pjesë, në urdhrin e ministrit do të përcaktohen lotet me fondin përkatës.

2. Për përzgjedhjen, kërkohen të ftohen të paktën 3 (tre) operatorë ekonomikë për projektin në total ose për secilin lot. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të pranojë oferta nga çdo ofertues tjetër, veç atyre të ftuar nga vetë ai.

3. Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën ngre komisionin e vlerësimit të cilësisë artistike dhe ofertës më të mirë ekonomike, i cili përbëhet minimalisht nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët janë specialistë të fushës përkatëse, një ekonomist për vlerësimin e ofertave ekonomike, një jurist për ndjekjen e procedurës dhe hartimin e dokumenteve të njoftimit, procesverbaleve deri në lidhjen e kontratës. Procesverbalet nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit. Komisioni ka për detyrë vlerësimin e ofertës më të mirë të paraqitur, duke u bazuar në cilësinë artistike të realizimit të veprimtarisë artistike e kulturore.

4. Në çdo rast, komisioni do të vlerësojë sipas formulës së mëposhtme:

- Subjektin fitues që paraqet projektidenë më të mirë dhe shërbime cilësore për realizimin e aktivitetit 7 pikë;
- Çmimin më të mirë 3 pikë.

5. Në përfundim të procedurës, komisioni harton raportin përmbledhës, i cili i drejtohet për miratim ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

6. Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën nënshkruan kontratën me subjektin fitues për të gjitha shërbimet që janë në funksion të projektit, duke përfshirë dhe angazhimin e artistëve.

IV. PROCEDURA E REALIZIMIT TË PROJEKTIT TË HARTUAR NGA MINISTRIA PËRGJEGJËSE PËR KULTURËN

1. Për projektet e hartuara nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën do të ndiqet procedura sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1, 2, 3 dhe 5 të kreut III të këtij vendimi.

2. Në çdo rast, komisioni do të vlerësojë për shërbime, marrje me qira, punime ndërtimi në funksion të projektit, promocione artistike, blerjen e produkteve në shërbim të projektit artistik e kulturor, cilësinë dhe çmimin më të leverdisshëm të ofruar.

3. Përfshihen nga procedura e konkurrimit rastet që paraqesin ekskluzivitet në funksion të veprimtarisë, si:

- a) angazhimi i specialistëve artistë të fushës (regjisorë, skenografë, interpretues, kostumografë, dirigjentë, drejtor artistik dhe të tjerë, rast pas rasti);
- b) konsulentë, specialistë të fushës;
- c) ekspozita të bukinistëve, fotografëve, grafistëve dhe të tjera, sipas rastit;
- ç) botime me të drejtë ekskluzive;
- d) plasticienët;
- dh) blerja e shërbimeve në funksion të veprimtarisë;
- e) rastet e tjera ekskluzive, të paparashikuara në këtë pikë në funksion të veprimtarisë.

4. Në rastet e përjashtimit nga konkurrimi, procedura shoqërohet me argumentimin e hollësishëm, të hartuar nga drejtoria përkatëse dhe ekspertë të fushës dhe të miratuar nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën.

5. Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën nënshkruan kontratat për realizimin e projektit.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ankesat për procedurën e konkurrimit për projektidenë më të mirë dhe veprimtarinë artistike e kulturore bëhen pranë ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit të klasifikimit përfundimtar. Vendimi i ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën ankimohet sipas procedurave ligjore në fuqi.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 24.10.2012
Doli nga shtypi më 24.10.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 20 lekë